

Grenelli: Kur Trumpi të bëhet president i ShBA-së do të punojmë për lirimin e Thaçit | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## 32 MUAJ QEVERISJE, KURTI THOTË SE KANË SHËNUAR TË ARRITURA

FAQE 4



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e 174-t të qeverisë, ka folur për 32 muajt e qeverisjes së tij. Ai nuk ka ngurruar të thurë lavde për kabinetin qeverisës. Ai ka thënë

se këto data u shërbejnë si moment reflektimi mbi atë se çfarë kanë arritur si ekip dhe ua kujtojnë se koha për t'i përbushur zotimet e tyre brenda mandatit të parë sa vjen

e pakohet. Kurti ka thënë se sot Kosova e ka ushtrinë më të fortë se kurrë ndërkohë, sipas tij, nga 1 janari pasaporta e republikës sonë do të jetë shumëfish më e fuqishme

### AKTUALE



PAPA: KONFLIKTI IZRAEL - HAMAS KA KALUAR NË 'TERRORIZËM' | F. 2

DY ZJARRE BRENDË VITIT NË MJEKËSINË LIGJORE, DËMET DHE SHKAQET ENDE TË PANJOHURA | F. 7

ABDIXHIKU: DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT KAM REFUZUAR TA SHOH | F. 3

### EKONOMI



IKJA E PUNËTORËVE NGA KOSOVA MUND T'I RRIË PAGAT | F. 8

ODA EKONOMIKE AMERIKANE: THEMELIMI I FONDIT SOVRAN FRENON RITJEN EKONOMIKE | F. 8

### SPORT



GLIHA EDHE ZYRTARISHT LARGOHET NGA KOSOVA | F. 10

REGJISTRIMI I POPULLSISË NË KOSOVË SHTYHET DERI NË PRANVERË | FAQE 3



DHJETË TË LËNDUAR NGA SHPËRTHIMI I NJË GRANATE DORE NË PRIZREN | FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Stoltenbergu: NATO-ja është e përkushtuar ta ruajë paqen në Ballkan

SHKUP, 22 NËNTOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha të mërkurën, pas një takimi në Shkup me liderët e shteteve anëtare të aleancës ushtarake nga Ballkani, se NATO-ja është e përkushtuar ta ruajë paqen dhe stabilitetin në këtë rajon.

Pas takimit me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski, atë të Shqipërisë, Edi Rama, presidentin e Kroacisë, Zoran Millovanović, dhe kryeministrin e Malit të Zi, Millojko Spajiq, shefi i NATO-s bëri thirrje që të hiqet dorë nga "kërkesat për ndarje në Bosnjë-Hercegovinë", si dhe për vazhdimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Stoltenbergu tha se NATO-ja nuk sheh kërcënim të drejtpërdrejtë ushtarak në rajon, por është e vetëdijshme për një rritje të tensioneve në Kosovë, edhe për kërcënime për ndarje në Bosnjë-Hercegovinë. "Ky rajon është shumë i rëndësishëm për NATO-n, dhe ka arsye për brengosje. Shohim kërcënime për ndarje në Bosnjë-Hercegovinë, gjendje të brishtë të sigurisë në Kosovë dhe ngecje të bisedimeve mes Beogradit dhe Prishtinës. Shtete autoritare si Rusia po rrezikojnë integritetin demokratik me kërcënime kibernetike", tha Stoltenbergu në Shkup.

Takimi i Stoltenbergut me liderët e Ballkanit në Shkup vjen pas turit të tij në vendet e Ballkanit, përfshirë Kosovën, ku qëndroi të hënën dhe u takua me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Ai tha se gjatë takimeve në rajonin e Ballkanit e ka theksuar rëndësinë e zgjedhjes së dialogut dhe demokracisë para konfliktit dhe luftës. "Kërkesat për ndarje e kërcënojnë paqen në Bosnjë, ndërsa dialogu në mes të Prishtinës dhe Beogradit është thelbësor në rrugën e tyre drejt paqes dhe prosperitetit. Propozimet e fundit për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë mund të jenë hapa me rëndësi përpara. Është koha që të kapërcehen konfliktet rajonale", nënvizoi shefi i aleancës ushtarake veriatlantike.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në takimin e liderëve të rajonit, ka kërkuar rritjen e pranisë ushtarake të NATO-s në Kosovë me qëllim të ruajtjes së paqes dhe të sigurisë.

NATO-ja e ka rritur tashmë praninë ushtarake në Kosovë, duke i dërguar 1 000 trupa shtesë në misionin e saj paqeruajtës KFOR - që përbën vendosjen më të madhe në vitet e fundit të aleancës - pas sulmit të 24 shtatorit ndaj Policisë së Kosovës nga një grup serbësh të



armatosur në veri të vendit. "Theksova edhe sot në këtë takim domosdoshmërinë e rritjes së numrit të forcave të NATO-s në Kosovë dhe domosdoshmërinë për ta garantuar kufirin mes Kosovës dhe Serbisë, i cili, faktikisht, është jashtë kontrollit dhe i cili në shërbim të aktiviteteve ilegale, të trafikut të armëve, të drogës, të aktiviteteve të cilat më pastaj ngatërrohen edhe me aktivitetin politik me sponde ultranacionaliste që shkakton devijime të rënda siç ishte

devijimi në Banjskë", ka deklaruar Rama.

Rama propozoi që formati i ardhshëm i këtij takimi të NATO-s të zhvillohet me praninë edhe të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të aleancës. "Kjo është shumë e rëndësishme, sikur që nuk duhet harruar për asnjë moment se paqja që kemi në këtë rajon është jashtëzakonisht e çmuar, edhe pse ka brishtësinë e vet", tha Rama.

Shefi i NATO-s ka thënë se do të shqyrtohet propozimi i Ramës, i

cili është mbështetur edhe nga pjesëmarrësit e tjerë në takim. "Me vjen mirë që ai e propozoi, sepse mua, mbase, nuk do të më kujtohej. Ndoshta është tepër ambicioz, por edhe mund të mos jetë. Nga kjo mund të ketë kemi vetëm përfitime", tha presidenti i Kroacisë, Millovanović. Në takimin e liderëve në Shkup, siç tha Stoltenbergu, është biseduar edhe për agresionin rus në Ukrainë dhe kontributin e shteteve anëtare të aleancës në mbrojtjen e sovranitetit të Ukrainës.

## Papa: Konflikti Izrael - Hamas ka kaluar në 'terrorizëm'

VATIKAN, 22 NËNTOR - Papa Françesku ka thënë të mërkurën se konflikti mes Izraelit dhe Hamasit - grupit radikal palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - e ka tejkaluar luftën edhe është bërë "terrorizëm".

Ai i bëri këto komente pas takimeve ndarëse me familjarët e pengjeve izraelite që po mbahen nga Hamasi dhe me palestinezët që kanë familjarë në Rripin e Gazës.

Duke folur para audiencës së tij të përgjithshme në Sheshin Shën Pjetri, pas takimeve në



rezidencën e tij mëngjesin e së mërkurës, Françesku tha se

dëgjoi nga afër se si "të dyja palët janë duke vuajtur" në

këtë konflikt. "Kjo është ajo çfarë shkaktojnë luftërat. Por, këtu ne i kemi tejkaluar luftërat. Kjo nuk është luftë. Ky është terrorizëm", tha Françesku.

Ai bëri thirrje për lutje në mënyrë që të dyja palët nuk do "të vazhdonin më pasionet, të cilat, në fund, i vrasin të gjithë".

Takimet dhe deklaratat e Françeskut vijnë disa orë pasi Qeveria e Izraelit dhe Hamasi u pajtuan për një ndërprerje katërditore të luftimeve, për të mundësuar lirimin e 50 pengjeve që po mbahen në

Gazë, në shkëmbim të liritimit të 150 palestinezëve të burgosur në Izrael dhe hyrjes së ndihmave humanitare në territorin e rrethuar.

Izraeli e ka rrethuar Gazën dhe e ka bombarduar pareshtur prej që Hamasi kreu sulme në qytetet e Izraelit jugor, ku i vrau 1 200 njerëz, kryesisht civilë, sipas zyrtarëve izraelitë.

Prej atëherë, më shumë se 13 000 palestinezë, rreth 40 për qind fëmijë, janë vlarë në Gazë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, e cila udhëhiqet nga Hamasi.

## Avionët amerikanë sulmojnë caqet e Hezbollahut irakian

UASHINGTON, 22 NËNTOR - Avionët luftarakë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë goditur dy qendra të Hezbollahut irakian si përgjigje ndaj sulmeve mbi bazat amerikane që janë përshkallëzuar gjatë luftës së

Izraelit në Rripin e Gazës, raporton "Associated Press". Gjatë sulmeve në bazat amerikane të martën u përdorën për herë të parë raketat balistike me rreze të shkurtra veprimi kundër trupave amerikane, sipas zyrtarëve amerikanë të

Mbrojtjes. Avionët luftarakë amerikanë i goditën qendrat e veprimit të Kataib Hezbollah dhe një qendër komandimi dhe kontrolli të Kataib Hezbollah në jug të Bagdadit të martën, thanë zyrtarët në kushte anonime.



# Abdixhiku: Draft-statutin e Asociacionit kam refuzuar ta shoh

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se kryeministri Albin Kurti nuk është i gatshëm të bashkëpunojë ose s'po kupton asgjë në dialog. "Për mua është e pakuptimtë. Ai na prezantoi një dokument me gjashtë pika, që ishin të pranueshme. I kam thënë kryeministrit a je vetëdijshëm për një dokument që po vjen si marrëveshje ndërkombëtare? Bëhej fjalë për marrëveshjen e normalizimit, marrëveshjen bazë. Një muaj pas e ka pranuar, por asnjëra nga 6 pikat nuk ishin aty", ka thënë Abdixhiku.

Ai në emisionin Debat Plus në RTV Dukagjini ka theksuar se tash me ndërkombëtarët nuk flitet për dialog normal, por



dialog për ta parandaluar luftën. "Tash më nuk flasim për normalizim të relacioneve, por

hajde ta ndalim luftën. Nga ky pozicion Kosova s'mund të nxjerrë asgjë mirë. Për mua është

e habitshme se si ti ke 6 pika si start, dhe në fund s'e ke asnjërinë në marrëveshje", ka thënë Abdixhiku.

Lideri i LDK-së ka komentuar deklaratën e presidentes Vjosa Osmani rreth draftit të statutit të Asociacionit, e cila ka thënë se i ka dykuptimësi. "Deklarata e Presidentes është vazhdimësi e deklaratës së parë, e cila vinte në kohën kur kryeministri i vendit kishte theksuar se atij i kishin thënë, ndonëse për ne ishte e pakuptimtë që s'ka mendim vetë, se drafti i statutit ishte në përputhje me Kushtetutën. E më pas kur ke dy liderë institucionalë që thonë gjëra të kundërta, bëhet një gjë shumë e rëndësishme. Ajo gjë është të ndahet drafti, së paku aktorët në vend, deputetët. I kuptoj

rrethanat që dialogu është çështje e interesave nacionale", është shprehur Abdixhiku.

Më tutje ai ka theksuar se e ka pasur ofertën për ta parë draftin e Asociacionit nga ndërmjetësuesit, por i njëjti e ka refuzuar. "Bëhet një muaj prej që është pranuar ky draft-statut. Bëhen një muaj e dy javë prej që Kosova e ka në dispozicion e një muaj që Vuçiqi e ka në dispozicion. Pra ta ketë Serbia e mos ta ketë Kosova është e pazakontë. Kemi pasur një ofertë nga ndërmjetësuesit që ja ku e keni draftin, mund ta shihni, por s'mund ta keni, e të cilin e kam refuzuar. E konsideroj ofendim të rëndë, që një dokument 20 e disa faqe t'u lihet forcave politike sa për shikim e jo për analizë", ka thënë Abdixhiku.

## Regjistrimi i popullsisë në Kosovë shtyhet deri në pranverë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Qeveria e Kosovës e ka shtyrë përsëri edhe për disa muaj procesin e regjistrimit të popullsisë, që tani parashihet të fillojë në prillin e vitit të ardhshëm.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën në mbledhjen e qeverisë, se procesi i regjistrimit "nuk është menaxhuar mirë" nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

Kreu i ekzekutivit ka përmendur, po ashtu, edhe udhëheqjen e re të ASK-së si faktor që e ka shtyrë ta

propozojë shtyrjen e sërishme të procesit të regjistrimit të popullsisë. Sipas vendimit të ri qeveritar, procesi do të zhvillohet nga 5 prilli deri më 17 maj të vitit 2024.

Më 23 gusht qeveria kishte vendosur ta shtynte për dy muaj procesin e regjistrimit të popullsisë dhe kishte paraparë që ai të niste më 1 nëntor. Duke e arsyetuar atë vendim gjatë një takimi të qeverisë, kryeministri Kurti kishte thënë se një sërë vonesash në proces e kishin bërë të pamundur nisjen e regjistrimit të popullsisë më 1 shtator. Ai kishte thënë se procesi ishte shtyrë shkaku i rezistencës nga

Komisioni Qendror i Regjistrimit nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë është bërë në vitin 2011, ndërsa regjistrimi që është dashur të bëhet në vitin 2021 është shtyrë për shkak të pandemisë Covid-19.

Sipas regjistrimit të bërë më 2011, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë llogaritet të jetë rreth 1.8 milion. Por, në këtë regjistrim nuk ishin përfshirë banorët e komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës - Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut - pasi që në atëkohë ata kishin refuzuar procesin.



## Qeveria kundërshton propozimin e KE-së për heqjen e vizave për shtetasit e Kosovës që kanë pasaporta të Serbisë

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Qeveria e Kosovës tha se është e shqetësuar me propozimin e Komisionit Evropian që vizat të hiqen për bartësit e pasaportave të Serbisë të cilët banojnë në territorin e Kosovës. Ekzekutivi kërkoi nga Bashkimi Evropian ta rishqyrtojë këtë propozim.

Përmes një reagimi të publikuar në rrjetet sociale, zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë se ky propozim i KE-së për pasaportat që lëshohen "nga e ashtuquajtura Drejtori Koordinuese serbe" nuk është diskutuar me Qeverinë e Kosovës. "Pasaportat ilegale të lëshuara nga Qendra Koordinuese e Serbisë i konsideron komunitet brenda Kosovës si pjesë të juridiksionit



të Serbisë, shkelje kjo e sovranitetit tonë dhe e papranueshme", është shprehur Bislimi. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës fton BE-në që këto dokumente "t'i trajtojë si të paligjshme ashtu siç trajton pjesën tjetër të dokumentacionit paralel".

Propozimi i KE-së u argumentua me faktin se liberalizimi i vizave do të nisë së zbatuari më 1 janar të vitit 2023.

Por, Bislimi ka thënë se liberalizimi i vizave për Kosovën nuk nënkupton që pjesëtarët e komunitetit serb do të mbesin pa liberalizim pasi ata, sipas tij, mund të pajisjen me pasaporta të lëshuara nga Kosova. "Qeveria jonë tashmë ka vënë në praktikë një procedurë të përshpejtuar për pajisjen e të gjithë serbëve të

Kosovës me pasaporta. Së fundmi është parë një interesim i lartë e rritje të numrave të qytetarëve që janë pajisur me pasaporta të Kosovës. Në krahasim me vitin e kaluar, kemi rritje prej 29-përqindësh", ka theksuar Bislimi, duke shtuar se këtë kundërshtim e kanë adresuar në instancat më të larta të BE-së.

"Mbetemi të përkushtuar që të sigurohemi që të gjitha komunitetet në Kosovë të mund të gëzojnë udhëtimin pa viza me pasaportat e Kosovës. Këtë kundërshtim në lidhje me propozimin e kemi adresuar drejt instancave më të larta të BE-së. I bëjmë thirrje BE-së ta rishqyrtojë këtë propozim, i cili përmban shkelje të shumëfishta", ka thënë Bislimi.



## 32 muaj qeverisje, Kurti thotë se kanë shënuar të arritura

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e 174-t të qeverisë, ka folur për 32 muajt e qeverisjes së tij. Ai nuk ka ngurruar të thurë lavde për kabinetin qeverisës. Ai ka thënë se këto data u shërbejnë si moment reflektimi mbi atë se çfarë kanë arritur si ekip dhe ua kujtojnë se koha për t'i përmbushur zotimet e tyre brenda mandatit të parë sa vjen e pakohet. Kurti ka thënë se sot Kosova e ka ushtrinë më të fortë se kurrë ndërkaq, sipas tij, nga 1 janari pasaporta e republikës sonë do të jetë shumëfish më e fuqishme

**EPOKA E RE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 22 NËNTOR** - Kryeministri Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë të mbajtur të mërkurën, ka bërë me dije se janë bërë 32 muaj prej ditës së parë të qeverisjes nën drejtimin e tij. "Nesër bëhen plot 32 muaj prej ditës së parë të qeverisjes sonë apo 2/3 e mandatit katërvjeçar", ka thënë Kurti, duke shtuar se janë data si këto që u shërbejnë si moment reflektimi mbi atë se çfarë kanë arritur si ekip. "Por edhe na kujtojnë se koha për t'i përmbushur zotimet tona dhe për t'i respektuar pritjet e

qytetarëve tanë brenda mandatit të parë sa vjen e pakohet. E meqë çdo ditë na përkujtohet secilit prej nesh, se çfarë nuk është bërë e çfarë ka mbetur të bëhet, sot po e shfrytëzoj rastin që të përmend vetëm disa gjëra, jo të gjitha që i kemi bërë", ka deklaruar kryeministri Kurti para kabinetit qeveritar.

Kryeministri ka theksuar se në përballje me pandeminë Covid-19, kur Kosova nuk kishte asnjë vaksinë dhe kishte mbetur e fundit dhe e vetmja në rajon që nuk kishte filluar procesin e vaksinimit, brenda 100 ditëve të para të qeverisjes së tij siguruan mbi 2 milionë vaksina. "Tetë muaj

pasi imunizuar 60 % të popullatës së rritur, siç kishim premtuar, dhe nga të fundit në rajon, u bëmë vendi i parë në Ballkanin Perëndimor për nga shkalla e vaksinimit të popullatës", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se rritjen ekonomike dhe të hyrat tatimore i rishpërndanë te qytetarët, veçanërisht në përballje me inflacionin dhe krizën energjetike, por jo vetëm. "Mbështetëm subvencionimin e tarifave të energjisë elektrike, të faturave të energjisë elektrike, të pajisjeve për efikasitet të energjisë. Mbështetëm studentët, familjet në nevojë, pensionistët e zyrtarët publikë. Mbështetëm punësimin e të rinjve përmes platformës SuperPuna, të grave, personave me aftësi të kufizuara dhe të anëtarëve të familjeve pa asnjë të punësuar. Subvencionuam pagën e rritur në sektorin privat. Mbështetëm bizneset në zgjerimin dhe rritjen e kapaciteteve të prodhimit e të eksportit në promovimin e produkteve tyre në panaire ndërkombëtare. U siguroam që faturat e energjisë elektrike për ta të jenë më të lira në rajon. Sipas Bankës Botërore, Kosova ka pasur

pakon mbështetëse më të madhe si përqindje e Bruto Produktit Vendor në rajon për qytetarët në përballje me inflacionin dhe krizën energjetike", është shprehur Kurti.

Sipas tij, nënat lehona për herë të parë marrin shtesa për vete dhe për fëmijët e tyre të porsalindur sikurse marrin të gjithë prindërit e fëmijëve nën moshën 16-vjeçare. Kurti ka thënë se të dhënat më të fundit tregojnë se janë 49 mijë nëna të reja që deri më tani kanë përfituar nga mbështetja mujore e shtetit dhe mbi 387 mijë fëmijë që e kanë ndier e vazhdojnë ta ndiejnë dorën e shtetit për ndihmën jetike.

Duke folur për arsimin publik të lartë, kryeministri ka thënë se atë e kanë bërë falas. "43 mijë studentë ndjekin studimet e tyre në nivelin bachelor dhe master, si e drejtë që ju takon, jo si shërbim për të cilin duhet të paguajnë. Po e lidhim shkollimin profesional me tregun e punës përmes arsimit dual. Këtë vit kemi 12 profile, që ofrohen në 21 shkolla, në 14 komuna të Kosovës. Arsimi dhe aftësimi profesional është një nga projektet më të mëdha të transformimit të ekonomisë sonë", ka pohuar Kurti.

### Ushtrinë e kemi më të fortë se kurrë

"Ushtrinë e kemi më të fortë se kurrë. I kemi ndarë buxhet më shumë se dyfish krahasuar me çfarë kishte, edhe atë po e rritim çdo vit. Ia shtuam 1 852 ushtarë të rinj dhe 600 të tjerë tashmë i kemi paraparë për vitin e ardhshëm. Ka armatim më shumë sepse investimet i kemi rritur për 191 %, gati trefishim. Përveç çizmes në tokë, ushtria jonë tani ka edhe sy në qiell me dronët Bayraktar", ka thënë kryeministri Kurti.

Ai thotë se me mbi 214 milionë euro mbështetje financiare deri më tani, fermeri i Kosovës sot është fermeri më i përkrahur në rajon. "Mbështetjen me subvencione për bujqit dhe fermerët e kemi rritur deri në 216 %, pra mbi trefishim, dhe për herë të parë kemi subvencionuar naftën dhe plehun bujqësor. Andaj edhe kemi rekord të mbjellave që prej pas luftës", ka deklaruar ai.

Duke folur për Lojërat Mesdhetare 2030, Kurti ka thënë se kjo do të jetë ngjarja më e madhe sportive që vendi ynë e organizon si nikoqir. "Për shtatë

## Grenelli: Kur Trumpi të bëhet president i ShBA-së do të punojmë për lirimin e Thaçit

Prishtinë, 22 nëntor - Ish-emisari i ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka thënë se kur Donald Trump të bëhet përsëri president, do të punojnë për lirimin e Hashim Thaçit. Grenelli në platformën "X" ka drejtuar akuza kundër

prokurorit Jack Smith. "Kthim prapa te takimi me mikun tim Hashim Thaçi në Kosovë. Presidenti Thaçi sot është në burgun e Hagës, sepse Jack Smith e urren Donald Trumpin dhe dëshiroi që të sigurohet që ai të mos bëjë përparim në

Ballkan. Dhe evropianët e lejuan këtë padrejtësi që të zgjatet. Kur Trumpi të bëhet përsëri president ne do të punojmë që ta lirojmë Hashim Thaçin. Ne kemi nevojë për drejtësi, jo për politikë", ka shkruar Grenelli.



## Rama: Rritja e forcave të NATO-s në Kosovë, domosdoshmëri



PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka përsëritur edhe njëherë nevojën për shtim të forcave të NATO-s në Kosovë, duke theksuar se rasti i Banjskës nxori në pah rrezikun e lartë për destabilizim dhe përshkallëzim të konfliktit. Sipas Ramës, sulmi i 24 shtatorit në veri të Kosovës nuk duhet të konsiderohet rast sporadik, por paralajmërim. Rama i bëri thirrje Aleancës për ruajtje të kufirit Kosovë - Serbi nga NATO-ja pasi, sipas tij, ai është burim i shumë të këqijave. "Jam i keqardhur për faktin që, pavarësisht prej thirrjeve të përsëritura për të shtuar në mënyrë të ndjeshme, jo vetëm vëmendjen, por edhe trupat, të cilat duhet të garantojnë stabilitet

dhe paprekshmëri absolute të Kosovës, ka ndodhur një ngjarje tragjike, e cila duhet konsideruar një paralajmërim dhe jo një ngjarje sporadike, e cila duhet me çdo kusht të mos përsëritet. Për këtë arsye theksova edhe sot në takim domosdoshmërinë e rritjes së numrit të forcave të NATO-s në Kosovë dhe domosdoshmërinë për ta garantuar kufirin mes Kosovës dhe Serbisë, i cili, faktikisht, është jashtë kontrollit dhe i cili është në shërbim të aktiviteteve ilegale të trafikut të armëve, të trafikut të drogës, të aktiviteteve, të cilat pastaj ngatërrohen siç e dimë të gjithë, edhe me aktivitetin politik, me sfond ultra nationalist që shkakton devijime të rënda, siç

ishite devijimi në Banjskë ku humbi jetën në krye të detyrës një punonjës i Policisë së Republikës së Kosovës dhe ku qartësisht doli në pah rrezikshmëria e lartë për destabilizim dhe përshkallëzim të një konflikti që, siç e tha sekretari i përgjithshëm, ka vetëm një vend për t'u trajtuar: në tryezën e dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian mes Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Rama, duke shtuar se NATO duhet të jetë më e pranishme në Kosovë dhe e angazhuar me më shumë trupa për ta siguruar kufirin mes Serbisë e Kosovës që është burim i shumë të këqijave nga i cili penetrojnë individë, grupe e forca që synojnë ta destabilizojnë Kosovën.

vjet kemi paraparë mbi 250 milionë euro investime publike, për t'i mirëpritur 26 shtete pjesëmarrëse e 23 disiplina sportive, mijëra atletë e dhjetëra mijëra turistë", ka theksuar ai. Kryeministri ka potencuar se krahas rrugëve, po ndërtojnë edhe hekurudha. "Tash së fundmi u shpall edhe kompania fituese për studimin e fizibilitetit dhe përgatitjen e projektit për linjën Prishtinë - Durrës. Ndërkaq, mbi 200 milionë euro janë paraparë për rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10, që do të mundësojë operimin e trenave me shpejtësi mbi 100km/orë në shumicën e seksioneve të linjës", ka thënë ai, duke shtuar se tekta po hapin rrugë të reja që rritin lëvizjen dhe nxisin shkëmbimet, qeveria nën drejtimin e tij ka mbyllur shumë rrugë ilegale që shfrytëzoheshin për kontrabandë, trafikim e kalim të paligjshëm të kufirit. "Gjithsej 34 sosh, prej tyre 26 vetëm në veri të vendit. Atje nga policia jonë u shkatërruan edhe nëntë laboratorë të drogës, nga 16 gjithsej, gjithandej territorit, dhe 6 laboratorë të prodhimit të kriptovalutave. Sot në katër komunat tona në veri ka më shumë siguri dhe qetësi për qytetarët tanë. Po asfaltohen rrugë e po ndërtohen shtëpi të reja, përfshirë edhe të banorëve shqiptarë të cilëve prona u ishte dëmtuar gjatë luftës së fundit në

Kosovë. Bashkëqytetarët tanë serbë tani janë më të lirë të vendosin vetë, sepse grupet kriminale që dikur terrorizonin banorët e atyre komunave, tani skutën e kanë diku tjetër, por nëpër Serbi. Andaj edhe kohën e fundit po shohim një interesim të lartë të tyre për t'u pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës. Vetëm këtë muaj, deri dje, janë mbi 2 100 konvertime të targave të veturave në RKS, në të njëjtën kohë që interesimi për t'u pajisur me pasaportë të Kosovës gjithashtu është rritur", është shprehur Kurti.

### Nga 1 janari pasaporta e Kosovës do të jetë shumëfish më e fuqishme

Kryeministri në vazhdimin e fjalës së tij para kabinetit qeveritar ka thënë se nga 1 janari i vitit të ardhshëm pasaporta e Republikës sonë do të jetë shumëfish më e fuqishme sepse, sipas tij, hyn në fuqi vendimi i Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave në Zonën Shengen. "Kjo arritje, përveçse meritë e kamotshme e qytetarëve tanë, është edhe rezultat i ligjshmërisë, i reformave, luftimit të korrupsionit dhe praktikave korruptive e i qeverisjes sonë të mirë me imazh të lartësuar

## Qeveria miraton projektligjin e ri, iu mundëson edhe qytetarëve nga 0-16 vjeç të pajisen me letërnjoftim

Qeveria në këtë mbledhje ka miratuar projektligjin e ri për letërnjoftime, përmes së cilit u mundësohet të gjithë qytetarëve që nga lindja të pajisen me letërnjoftim. Kështu ka bërë me dije ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. "Si risi e këtij projektligji është krijimi i mundësisë që shtetasit i Kosovës nga lindja deri në moshën 16-

vjeçare të mund të pajiset me letërnjoftim, por pa qenë i detyruar. Kjo do t'u mundësojë qytetarëve të kësaj moshe të lëvizin jashtë Republikës së Kosovës vetëm me letërnjoftim në ato vende me të cilat ka marrëveshje Republika e Kosovës", ka thënë Sveçla. Siç ka deklaruar ai, projektligji, po ashtu, rregullon shfrytëzimin e të dhënave elektronike nga

letërnjoftimi, formën dhe përmbajtjen, afatin e vlefshmërisë së tij si dhe rregullat në rast të dëmtimit, humbjes apo vjedhjes së letërnjoftimit. "Ky projektligj është hartuar në pajtim me programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023, Kushtetutën si dhe direktivat e Bashkimit Evropian", ka thënë ministri Sveçla.

ndërkombëtarisht. Më tej, duke aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian, aspiratën e përkthyer në proces në të cilin e për të cilin angazhohemi çdo ditë", është shprehur ai. Me gjithë këto, sipas Kurtit, përmirësimi i indikatorëve të luftimit të korrupsionit dhe respektimit të ligjit nuk është i mjaftueshëm pa sistem të mirëfilltë, të pavarur e profesional të drejtësisë. "Kjo bëhet e mundshme vetëm nëpërmjet vetingut. Për këtë kemi finalizuar amendamentet Kushtetuese dhe draftin e parë të Projektligjit për vetingun, i cili po vazhdon të jetë në trajtim e pa përgjigje nga

Gjykata Kushtetuese tash e nëntë muaj. Vendi ynë nuk ka nevojë vetëm për drejtësi tash e tutje. Ka po aq nevojë edhe për drejtësi, edhe për të kaluarën. Prandaj e kemi Institutin për Hulumtimin dhe Dokumentimin e Krimeve të kryera gjatë Luftës në Kosovë, që për herë të parë po themelohet nëpërmjet ligjit, e që do t'i adresojë krimet e Serbisë në luftën e viteve 1998-1999", ka pohuar Kurti. Ai ka falënderuar për punën e deritanishme secilin prej ministrave. "E pa humbur kohë, le ta vazhdojmë punën dhe shërbimin në këtë mbledhje të 174-t në të cilën, ndër të tjera, do të shqyrtohen për miratim

gjashtë projektligje, ndër to edhe Projektligji për Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Ky Projektligj, si mjet kundër korrupsionit e shpëlarjes së parave, do ta tregojë pronarin e fundit në zinxhir dhe adresën e fundit të përfitimit të parasë publike përmes proceseve tenderuese. Në vazhdim do ta shqyrtojmë për miratim edhe Projektligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, projektligji ky i hartuar në dritën e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe udhëzimet e implementimit të këtyre standardeve të Këshillit të Evropës", ka thënë kryeministri Kurti.

## Limaj takohet me kryetarët e degëve të Nismës, diskutojnë për funksionimin e strukturave të partisë

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Nën drejtimin e kryetarit të Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, është mbajtur takimi i rregullt me kryetarët e degëve, në të cilin është diskutuar për aktivitetet e

deritanishme dhe planet për një funksionim sa më të mirë të strukturave të partisë. Në këtë takim kryetari Limaj i ka falënderuar të gjithë drejtuesit e degëve të Nismës për angazhimin dhe

bashkëpunimin e deritanishëm si dhe ka shprehur gatishmërinë për të qenë edhe më bashkëpunues me qëllim të realizimit të projekteve politike në interes të qytetarëve.



## Nis aplikimi për subvencionimin e pajisjeve eficiente të ngrohjes për bizneset

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Ministria e Ekonomisë ka shpallur të mërkurën thirrjen publike për subvencionim të pajisjeve eficiente për ngrohje në mbështetje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme financuar nga Bashkimi Evropian (BE).

Masat që janë paraqitur synojnë mbështetjen e bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme, si investim në instalimin e pajisjeve eficiente për ngrohje, e të cilat përfshijnë: Pompë termike; Kondicioner/ klimë eficiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë); Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket); Stufa individuale me biomasë. "Vlera e subvencionimit për një pajisje pompë termike është 20 % e vlerës investive, apo deri në 2 000.00 euro. Kurse për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi

të grave nga 51 % e tutje, vlera e subvencionimit është 25 % e vlerës investive dhe deri në 2 000.00 euro", ka njoftuar ME.

Ndërkaq për kondicioner/ klimë (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë), vlera e subvencionimit për një pajisje është 20 % e vlerës investive, apo deri në 1 000.00 euro. Për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave nga 51 % e tutje, vlera e subvencionimit është 25 % e vlerës investive dhe deri në 1 000.00 euro. "Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket), subvencionohet 40 % e vlerës investive, dhe deri në 2 000.00 euro. Për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave nga 51 % e tutje, vlera e subvencionimit është 45 % e vlerës investive dhe deri në 2 000.00 euro. Ndërsa, stufa individuale me biomasë, vlera e subvencionimit për një pajisje është 40 % e vlerës



investive dhe deri në 500.00 euro. Për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave nga 51 % e tutje, vlera e subvencionimit është 45 % e vlerës investive dhe deri në 500.00 euro", ka njoftuar

Ministria e Ekonomisë, duke theksuar se aplikimi për subvencionim është ndarë në dy faza.

Afati i fundit për aplikim për fazën e parë është 21 ditë kalendarike


nga dita që hapet thirrja, pra deri më 12 dhjetor 2023 ose deri në shpenzimin e buxhetit të alokuar për këtë thirrje. Ndërsa afati i fundit për fazën e dytë është deri më 10 janar 2024.

## "KosovaPar2023", qeveria zotohet se reforma e administratës publike është prioritet

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në ceremoninë hapëse të Konferencës "KosovaPar2023", në të cilën është diskutuar për të ardhmen e administratës publike, fleksibilitetin, stabilitetin dhe digjitalizimin e administratës publike, organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ngjarje kjo e cila do të bëhet vjetore.

Fjalën e tij kryeministri Kurti e nisi me një falënderim ndaj ministrisë përkatëse për organizimin e kësaj konference, siç e ka quajtur ai, shumë të rëndësishme për vendin tonë dhe për administratën publike.

Për kryeministrin Kurti, këto konferenca janë të rëndësishme sepse bëjnë bashkë akademikë, zyrtarë publikë nga vendi dhe bota për të debatuar, për të



shkëmbyer ide dhe përvoja rreth praktikave më të mira të reformimit të administratës publike. "Reforma e

administratës publike, dua të theksoj, është prioritet i qeverisë sonë. Praktika e shteteve të tjera në Evropë ka dëshmuar se një

administratë publike efikase, moderne, transparente dhe llogaridhënëse është çelësi i të gjitha reformave të tjera. Pra,

reforma e administratës publike nuk është si çfarëdo reforme tjetër, për shkak se ajo është reforma që mundëson reformat e tjera", u shpreh kryeministri.

Kurti veçoi se reforma e administratës publike gjithashtu sjell përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë, rritjen ekonomike, drejtësinë dhe punësimin, rrjedhimisht edhe integrimin evropian e euro-atlantik. "Andaj ne jemi të përkushtuar që këto reforma t'i bëjmë realitet", është shprehur Kurti.

Ndërkaq ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se kjo konferencë ndërkombëtare, e para e këtij lloji që organizohet në Kosovë, tregon se synimi ynë për një administratë shtetërore moderne dhe efikase nuk ishte vetëm premtim.

## Për një vit në Klinikën e Pediatrië u trajtuan rreth 57 mijë fëmijë

PRISHTINË, 22 NËNTOR - 56 mijë e 970 fëmijë me probleme të ndryshme shëndetësore janë trajtuar në Klinikën e Pediatrië të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës nga 1 janari i këtij viti e deri më

tani. Numrin më të madh të fëmijëve të trajtuar ka pasur Shërbimi Emergjent, me 38 mijë e 257 fëmijë, ku 6 mijë e 288 fëmijë janë pranuar për trajtim të mëtutjeshëm shëndetësorë në reparte të

ndryshme të kësaj klinike. Numër i madh i fëmijëve janë trajtuar nga specialistë pediatër të profileve të ndryshme. Sipas statistikave, deri tani në këtë vit ka pasur 18 713 vizita specialiste.



# Dy zjarre brenda vitit në Mjekësinë Ligjore, dëmet dhe shkaqet ende të panjohura

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Brenda këtij viti Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) i Kosovës është kapluar dy herë nga zjarri. Edhe pse dëmet dhe shkaqet e zjarreve ende nuk dihen për asnjërin rast, për Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) këto dy raste simbolizojnë neglizhencën që i është bërë këtij Instituti. “Dështimet, një pas një, në menaxhim, na sjellin në situata të tilla. Me vetë faktin që ky institut udhëhiqet me ushtrues detyre dhe që për kohë të gjatë nuk kanë arritur ta zgjedhin drejtorin, në njëfarë mënyre dëshmon se Instituti i Mjekësisë Ligjore nuk është në interesin e Ministrisë së Drejtësisë”, thekson Miftaraj. “Radio Evropa e Lirë” ka kontaktuar Ministrinë e Drejtësisë lidhur me këtë temë, mirëpo i është thënë t’i referohet një komunikate të publikuar në faqen e Ministrisë së Drejtësisë. Në atë komunikatë vetëm bëhet me dije se në zyrat e këtij Instituti ka shpërthyer një zjarr.

Zjarri që kaploi ndërtesën e këtij Instituti më 21 nëntor përfshiu disa zyra në katin e dytë të ndërtesës si dhe pjesën e çatisë mbi të. Një tjetër zjarr në IML kishte shpërthyer edhe më 25 mars të këtij viti.

Prokuroria Themelore e Prishtinës pati nisur hetimet lidhur me rastin por, sipas zëdhënësës së kësaj prokurorie, Laureta Ulaj, rasti ende nuk ka marrë një epilog. “Mund t’ju njoftojmë se edhe ky rast ende ndodhet në proces hetimor në prokurorinë tonë”, thekson Ulaj. Miftaraj nga IKD-ja thekson se prokuroria ka afat ligjor prej 30-muajsh për të bërë hetime. Por, sipas tij, kur bëhet fjalë për zjarr “në një objekt shtetëror, ku



hetimet bëhen në vendin e ngjarjes”, ato është dashur të jenë më të shpejta dhe të mos neglizhohen nga prokuroria. Ai shton se për shkak të ndjeshmërisë si institucionit, Instituti i Mjekësisë Ligjore është dashur të ruhet nga Policia e Kosovës qysh pas shpërthimit të mëhershëm të zjarrit në objektin e saj në mars të këtij viti. Pas shpërthimit të fundit të zjarrit në IML, në vendin e ngjarjes kishin arritur zjarrfikësit, ndërkaq policia tha se zjarri ishte lokalizuar.

Prokuroria Themelore e Prishtinës ka bërë me dije se është duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për t’i sqaruar shkaqet e zjarrit. Zëdhënësja e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, Ulaj, thotë se Prokurori i Shtetit është duke pritur raportin me gjetjet nga ekzaminimet në vendin e ngjarjes. Sipas saj, prokuroria ende është në fazën e hetimit dhe

për të mos e paragjykuar rastin, ajo thotë se nuk mund të japë ndonjë vlerësim për shkaqet e zjarrit dhe dëmet e shkaktuara. Se cilat janë dëmet nga shpërthimi i zjarrit në Institut, nuk ka sqaruar në mënyrë specifike as ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, e cila, të martën, përmes një postimi në rrjetin “Facebook”, ka folur për to. “Nga vlerësimet fillestare nuk ka pasur djegie ose dëmtim të mjetëve mortore, arkivit të IML-së dhe mostrave”, ka shkruar Haxhiu.

Ajo ka shtuar se lidhur me zjarrin në Institut, qytetarët “me të drejtë” mund të jenë të shqetësuar “për shkak të atyre që kanë ndodhur në IML ndër vite”. Por, siç ka thënë ajo, “pa e kuptuar shkakun e zjarrit”, nuk mund të japë më shumë informacione. “Eventualisht, në rast se paraqiten elemente të ndonjë veprë penale, atëherë [prokuroria] do t’i ndërmarr të gjitha veprimet e

nevojshme në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës”, thekson Ulaj për “REL”-in.

Dëmet e tërësishme që mund të jenë shkaktuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore ende nuk dihen. Për të mësuar më shumë lidhur me dëmet eventuale të shkaktuara nga zjarri në Institutin e Mjekësisë Ligjore, “Radio Evropa e Lirë” ka bërë përpjekje ta kontaktojë ushtruesin e detyrës së drejtorit të këtij Instituti, Ditor Halitin, por ai nuk u është përgjigjur thirrjeve dhe mesazheve telefonike të “REL”-it. Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), që mbikëqyr punën e institucioneve të drejtësisë, në një bisedë me “Radion Evropa e Lirë” e cilëson deklaratën e ministres Haxhiu “të hershme”. “Nuk do të duhej të paragjykonte pa pasur një hetim të pavarur nga ana e institucioneve kompetente. Duket se kjo është një strategji e

ministres për ta zvogëluar dëmin që po ndodh në këtë institut, për herë të dytë gjatë këtij viti”, thekson Miftaraj. Sipas Miftaraj, në këtë institut ruhen provat që kanë të bëjnë me veprat penale të vrasjes, veprat penale të dhunës seksuale apo edhe vepra të tjera penale.

Miftaraj thotë se shkatërrimi eventual i tyre nga zjarri do të ndikonte drejtpërdrejt në procedurat e tjera penale.

Ky institut është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit mjekoligjor në vend, për të siguruar shërbime mjekoligjore, mësimdhënie dhe shërbime përkrahëse për familjet e personave të zhdukur. Po ashtu, Instituti ka për detyrë sigurimin e ekspertizës mjekoligjore për organet publike, udhëheqjen e hetimeve mjekësore për vdekjen në vendin e ngjarjes, kryerjen e zvarrosjeve, kryerjen e inspektimeve pas vdekjes dhe kryerjen e autopsive.

## Dhjetë të lënduar nga shpërthimi i një granate dore në Prizren

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRIZREN, 22 NËNTOR - Dhjetë persona janë lënduar në orët e hershme të së mërkurës së 22 nëntorit si pasojë e shpërthimit të një granate dore në një treg të kafshëve në qytetin jugor të Kosovës, Prizren. Pesë nga të lënduarit janë dërguar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë, ndërsa të tjerët janë liruar nga spitali, tha shefi i Emergjencës në Spitalin Rajonal të Prizrenit, Hekuran Veçgishti. “Ata u transferuan në QKUK për shkak të lëndimeve në gjoks dhe qafë, si dhe për shkak të mungesës së kirurgut torakal në Spitalin e Prizrenit”, tha Veçgishti.

Sipas tij, gjendja e të lënduarve nga granata e dorës në Prizren është stabile.

Ndërkohë, zëdhënësi për Informim i Drejtorisë Rajonale



të Policisë së Prizrenit, Vesel Gashi, theksoi se tre persona të dyshuar për incidentin janë identifikuar dhe janë duke u kërkuar nga policia. “Rreth orës

04:50 policia ka pranuar informatë për një rast plagosjeje te tregu i kafshëve në Prizren. Nga informatat e para dyshohet se nëntë perona kanë pësuar

lëndime nga shpërthimi i një granate dore”, tha Gashi, duke shtuar se të lënduarit janë dërguar në emergjencën e Spitalit Rajonal të Prizrenit dhe

po marrin trajtim mjekësor. Në vendngjarje ka dalë edhe njësi i hetimeve rajonale të Prizrenit për të mbledhur prova për rastin.

# Ikja e punëtorëve nga Kosova mund t'i rrisë pagat

PRISHTINE, 22 NËNTOR - "Për një rrogë më të lartë... ndoshta 500-600 euro do të punoja", thotë Sanija Kadriu, e cila për më shumë se dhjetë vjet është jashtë tregut të punës. E deklaruar nga pagat e ulëta në sektorin privat dhe në pamundësi për t'u punësuar në sektorin publik, Sanija po i kalon vitet '50 të jetës së saj e papunë. "Kam qëndruar në shtëpi dhe jam kujdesur për dy fëmijët. Një pagë 300 euro ka qenë e paleverdshme për mua. Vetëm çerdhja e njërit fëmijë kushtonte 100 euro dhe me një pagë të vogël nuk arrija t'i mbuloja të gjitha shpenzimet", thotë Sanija, që ka përfunduar shkollimin e mesëm në ekonomi.

Në Kosovë mbi 60 për qind e qytetarëve në moshë pune janë ekonomikisht joaktivë - persona që nuk janë as të punësuar, as të regjistruar si të papunë dhe as nuk kërkojnë punë.

Duke pasur parasysh këto shifra, Banka Botërore i tha "Radios Evropa e Lirë" se Kosova ka potencial të madh të pasfrytëzuar të fuqisë punëtore, veçanërisht kur vjen fjala te gratë. Nga mbi 730 mijë qytetarë ekonomikisht joaktivë, prej tyre mbi 460 mijë janë gra.

Pas liberalizimit të vizave me vendet evropiane, Banka Botërore tha se, sipas parashikimeve, tregu i punës do të vazhdojë të ndikohet nga migrimi i ligjshëm i fuqisë punëtore, ashtu si edhe në të kaluarën. "Migrimi mund të ushtrojë presione për paga më të larta dhe kjo mund të nxjerrë më shumë qytetarë nga mospjesëmarrja në tregun e punës", thanë nga Banka Botërore për "Radios Evropa e Lirë".

Paga mesatare bruto në sektorin publik në Kosovë, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, është 604 euro, ndërsa në sektorin privat është 473 euro.

Nivelin e pagës mesatare bruto në Kosovë e ka diktuar edhe paga

minimale, që nuk ka ndryshuar që nga viti 2011 dhe sillet nga 130 deri në 170 euro.

E nga 1 janari i vitit 2024 kosovarët do të mund të udhëtojnë pa viza në vendet e Zonës Shengen. Udhëtimet pa viza shërbejnë për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme dhe në asnjë rast nuk nënkuptojnë leje pune. Sipas shifrave zyrtare, trendi i emigrimit të kosovarëve tashmë është në rritje. Sipas ASK-së, gjatë vitit 2021 nga Kosova janë larguar mbi 42 mijë banorë.

Kjo shifër ishte dukshëm më e ulët disa vjet më parë - në vitin 2018, rreth 28 mijë kosovarë ishin larguar nga vendi. Sipas të dhënave të ASK-së, arsyet e emigrimit kanë qenë të ndryshme, në mesin e tyre edhe punësimi.

Një anketë e Institutit Republikan Ndërkombëtar, me seli në Shtetet e Bashkuara, e publikuar në nëntor të vitit 2021, ka treguar se 78 për qind e kosovarëve të moshës 18 deri në 35 vjeç "ndoshta" ose "përfundimisht" do të largoheshin nga vendi i tyre, nëse do të kishin mundësi.

## Bizneset me strategji për kushte më të mira të punës

Drejtori i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, Skënder Krasniqi, thotë për "Radios Evropa e Lirë" se bizneset kanë nisur të mendojnë se si të ofrojnë kushte më të mira për punëtorët. Ai thotë se angazhimi i qytetarëve joaktivë në tregun e punës mund të bëhet përmes ngritjes së pagave, por shton se, për ta arritur këtë gjë, kompanitë kanë nevojë për ndihmë nga institucionet.

Me synim rritjen e punësimit dhe ofrimin e pagave më të larta në sektorin privat, Qeveria e Kosovës në fillim të këtij viti lansoi



platformën "Superpuna". Përmes kësaj platforme, punëdhënësit mund të subvencionoheshin me nga 264 euro në muaj për ta mbuluar pagën e një punëtori. Punëdhënësi ka mundur t'i ofrojë punëtorit të tij pagë më të madhe se atë duke shtuar pjesën tjetër vetë.

E pas periudhës gjashtëmujore, atë që zgjaste subvencionimi, punëdhënësi mund ta mbante në punë punëtorin duke nënshkruar kontratë të re, por edhe mund ta shkarkonte. Përmes kësaj platforme janë punësuar mbi pesë mijë të rinj.

Brahim Selimaj, pronar i një kompanie ndërtimesh në Kosovë, thotë për "REL"-in se është duke menduar se si do të veprojë pas janarit, kur thotë se "pret ikje të qytetarëve, rrjedhimisht fuqisë punëtore". "Jo vetëm biznesi im, por edhe bizneset e tjera kanë filluar t'i rrisin pagat për ta ndaluar ikjen, por vështirë se mund të ndalet", thotë Selimaj. Sipas tij, emigrimi do të

mund të ndalej vetëm nëse sektorët e arsimit dhe shëndetësisë do të ishin më cilësorë.

Ndërkaq, për fuqinë e madhe punëtore të Kosovës, e cila vazhdon të jetë jashtë tregut të punës, Selimaj thotë se shumë prej tyre janë kuadro që nuk i kërkon tregu i punës. "Ne kemi përgatitur të rinj në profesione që nuk i kërkon tregu i punës. Kemi hapur universitete të shumta dhe rinia jonë ka studiuar, derisa tregu i punës ka kërkuar shkollë profesionale në profile të ndryshme", thotë Selimaj.

Jusuf Azemi, kryetar i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, thotë për "REL"-in se edhe pagat më të larta nuk do të mund t'i ndalin të rinjtë të ikin nga vendi për të gjetur mundësi më të mira për punë. "Këtyre punëtorëve që janë përcaktuar të ikin nga Kosova edhe nëse i japin pagë prej 1 000 eurosh, ata nuk do të qëndrojnë këtu. Njerëzit janë mbushur me premtime që nuk janë realizuar.

Tani edhe ata që janë jashtë tregut të punës vështirë se mund të kycen. Do të jetë e vështirë", thotë Azemi.

Në seancën parlamentare më 16 nëntor, gjatë shqyrtimit të Projektligjit për buxhetin e vitit 2024, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për mosveprim të institucioneve ndaj asaj që e quajti "zbrazje të Kosovës nga të rinjtë".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u përgjigj se nga janari do të ketë emigrim, por jo zbrazje të vendit. Ai tha se Qeveria e Kosovës ka synim uljen e varfërisë.

Kosova nuk ka të dhëna të përditësuara për varfërinë në vend. Të fundit, të përpiluara nga ASK-ja dhe Banka Botërore, janë të vitit 2017. Sipas tyre, 18 për qind e popullsisë së Kosovës jeton në varfëri, përkatësisht me rreth 2 euro në ditë, kurse 5.1 për qind në varfëri të skajshme apo me më pak se 1.5 euro në ditë.

## Oda Ekonomike Amerikane: Themelimi i Fondit Sovran frenon rritjen ekonomike

PRISHTINE, 22 NËNTOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë vlerëson përpjekjet për përshtetimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës si dhe për tejkalimin e sfidave me të cilat përballlet Republika e Kosovës. Përderisa iniciativa e Qeverisë së Kosovës për themelimin e një Fondi Sovran mund të vlerësohet pozitive, sidomos në kontekstin e ndërtimit të një portofoli të investimeve dhe diversifikimit të burimeve financiare, Oda Amerikane mendon se ka strategji alternative që mund të jenë më të përshtatshme. Veçanërisht, privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve shoqërore mund të sjellë rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme për ekonominë. "Kosova, si një vend me sfida ekonomike, ka burime të kufizuara financiare

për investime strategjike. Fondi Sovran do të kërkonte një alokim të madh të këtyre burimeve, duke lënë pas dore fushat e tjera prioritare. Një hap i tillë do të mund të çonte në rritjen e ngarkesës fiskale dhe frenimin e rritjes ekonomike. Prandaj, Oda Amerikane beson fuqishëm se mjetet e buxhetit, edhe ashtu të kufizuara të shtetit, duhet të investohen në fusha kritike, të cilat përfshijnë arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën, bujqësinë, turizmin, prodhimin vendor, ndërmarrësinë dhe rritjen e aftësive profesionale. Investimet direkte në këta sektorë mund ta ndihmojnë qeverinë t'i adresojë më shpejt dhe në mënyrë më të efektshme nevojat aktuale të ekonomisë, duke sjellë rritje afatgjatë, të qëndrueshme dhe punësim




cilësor. Veçanërisht, kur fokusohet te sektorët prodhues, vendi mund ta ulë varësinë nga importet dhe ta nxisë aftësinë e vetëmjaftueshmërisë ekonomike", thuhet në komunikatën e kësaj ode. Sipas Odës Ekonomike

Amerikane, derisa fondet sovraane mund të ofrojnë kthime të mira mbi investimet, ato gjithashtu bartin edhe një nivel rreziku. "Për më tepër, inkorporimi i aseteve të ndërmarrjeve publike me performancë të dobët në

Fondin Sovran nuk duket si një hap i mençur për ta garantuar qëndrueshmërinë dhe rendimentin e duhur", theksohet në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane. Sipas Odës Ekonomike Amerikane, menaxhimi efikas i një fondi sovran kërkon një ekip ekspertësh financiarë me përvojë dhe njohuri të thella. Kosova mund të përballlet me sfida për të ndërtuar këtë lloj ekspertize, duke e ditur që një numër i organizatave shtetërore nuk e kanë të zgjidhur çështjen e udhëheqjes dhe menaxhimit. Pa një menaxhim dhe mbikëqyrje të duhur, Fondi Sovran mund të përballlet me vështirësi në arritjen e objektivave financiare", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.







Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Duka për shortin në 'Euro 2024': Pëlqej një ndeshje me Serbinë

**TRANË, 22 NËNTOR** - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF), Armand Duka, ka thënë se do të pëlqente që shorti për "Euro 2024" në vazën e tretë, Shqipërisë t'i takonte që të përballej, ose me skuadrën slovene, ose me atë serbe. I pyetur nga gazetari Blendi Fevziu në "Opinion" në Tv Klan se pse do të pëlqente

një ndeshje kundër Serbisë, Duka ka thënë se nuk i shikon si një ekip shumë i fortë në futboll në krahasim me skuadrat e tjera në këtë vazo. "Rregullat e shortit janë të ndara në 4 vazo. Shqipëria është në vazën e dytë dhe do të kemi kundërshtarë nga një nga çdo vazo nga e para, e treta dhe e katërta. Aty nuk ka asnjë

skuadër të dobët. Nëse do të nisemi me vlerësimin e skuadrave për nga historia, Shqipëria mund të konsiderohet me më pak rezultate", ka thënë Duka. "Nga ato skuadrat e vazos së parë që më pëlqen aty është Gjermania. Jo vetëm që bëjmë ndeshjen hapëse, por mund të luajmë më mirë futboll kundër

Gjermanisë sesa kundër atyre pesë të tjerave, nuk më duket në momentin më të mirë Gjermania. Ata janë shumë të forta të gjitha. E ke të vështirë t'i zgjedhësh dhe me dorë, kështu që çfarëdo që të sjellë shorti. Nëse do t'i zgjidhje me dorë, unë do ta pëlqejja Gjermaninë te vazoja e parë, Slloveninë ose Serbinë tek vazoja e tretë. Unë



po flas për futboll sepse nuk ka qenë ndonjë ekip shumë... Këtu janë të gjitha skuadrat të forta", ka deklaruar i pari i FShF-së.

## Gliha edhe zyrtarisht largohet nga Kosova

Federata e Futbollit e Kosovës ka konfirmuar ndarjen të mërkurën me përzgjedhësin Primozh Gliha. Ky i fundit, "dardanët" i ka drejtuar në gjashtë ndeshje në të cilat regjistroi dy fitore, dy humbje dhe dy barazime. FFK-ja ka paralajmëruar edhe masa të tjera pas rezultateve dëshpëruese

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 22 NËNTOR** - Primozh Gliha nuk do të jetë më trajner i Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Lajmin e ka konfirmuar Federata e Futbollit e Kosovës. Gliha i drejtoi "dardanët" në gjashtë ndeshje ku regjistroi dy fitore, dy humbje dhe dy barazime. "Me përfundimin e ciklit kualifikues për Kampionatin Evropian 2024, ka përfunduar edhe marrëveshja me trajnerin e deritanishëm Primozh Gliha. FFK-ja e falënderon përzgjedhësin Gliha për punën e tij në krye të ekipit kombëtar në gjashtë ndeshjet kualifikuese të zhvilluara", thuhet në njoftimin e FFK-së. Primozh Gliha mori drejtimin e Kosovës pas shkarkimit të përzgjedhësit

Alain Giresse. FFK-ja poashtu ka njoftuar se do të analizohet situata në Përfaqësuesen A dhe do të gjejë edhe trajnerin e ri. "Federata e Futbollit e Kosovës tashmë ka filluar analizimin e thellë të situatës aktuale në ekipin kombëtar A dhe pas kësaj analize do të merren masat adekuate dhe veprimet e ardhshme, përfshirë edhe angazhimin e përzgjedhësit të ri që do t'i prijë ekipit kombëtar", thuhet në njoftimin e shtëpisë së futbollit kosovar. Përfaqësuesja e Kosovës pati një fushatë zhgënjyese për kualifikueset e Kampionatit Evropian ku nga 10 ndeshje të zhvilluara regjistroi dy fitore, pesë ndeshje dhe tri humbje. "Dardanët" përfunduan në vendin e parafundit me 11 pikë në vendin e parafundit.



## UEFA publikon çmimet e biletave të Euro 2024

**BERLIN, 22 NËNTOR** - Kombëtarja shqiptare e futbollit ka siguruar kualifikimin në "Euro 2024" dhe tifozët shqiptarë, ashtu si në "Euro 2016", do të kenë një interes të jashtëzakonshëm që edhe në Gjermani t'i mbushin shkallët e stadiumeve për ta mbështetur Shqipërinë në rrugëtimin e saj. UEFA ka mbyllur që në muajin nëntor pjesën e parë të programit të shitjes së biletave për ndeshjet e Evropianit, të cilat janë shpërndarë në bazë të një lotarie të veçantë që ka organizuar me shitjen nëpërmjet faqes së internetit të saj, pa ditur në fakt se



cilat do të ishin skuadrat dhe duelet për të cilat u blenë biletat. Së shpejti nis faza e dytë e shitjes së biletave, ajo në të cilën mund të blesh për një ekip specifik, që është kualifikuar në këtë turne. Kjo fazë e dytë nis më 2 dhjetor, pasi të jetë hedhur shorti i fazës në grupe të turneut, dhe të gjithë të dinë se në cilat qytete e stadione luajnë. UEFA do të nxjerrë në shitje biletat në bashkëpunim me federatat përkatëse, kjo do të thotë se do t'ua delegojë atyre të drejtën e shitjes nëpërmjet portaleve të dedikuara. Kjo

nënkupton se që nga data 2 dhjetor, pasi të njihen kundërshtarët dhe stadiumet ku do të luhen tri sfidat e fazës në grupe, FShF-ja do të ketë në dispozicion biletat. Më pas FShF-ja do t'i nxjerrë në shitje një numër të caktuar për tifozët e interesuar për t'i blerë biletat, të cilët do të jenë të shumtë. Çmimet janë të pandryshueshme, me katër kategori biletash. 30 euro është më e lira, pastaj vazhdohet me 60 euro, 150 euro dhe 200 euro në fazën në grupe. Përjashtim bën vetëm ndeshja hapëse me çmime më të larta.

## Khaka: Shpresoj të shkojmë në Evropian me Yakinin

**Cyrih, 22 nëntor** - Kapiteni i Zvicrës, Granit Khaka, është shprehur se dëshira e tij është të shkojë në Kampionatin Evropian me trajnerin Murat Yakin. "Shpresoj që të shkojmë në Evropian me

Murat Yakin", u shpreh Khaka për mediat zvicereze 20min.ch. Sipas Khakës, mund të ndodhë që trajnerët dhe lojtarët të kenë mendime të ndryshme. "Kjo nuk do të thotë se ka probleme, kështu

e shoh unë, kështu e sheh trajneri. Nëse do të kishim fituar katër ndeshjet e fundit me shanset që kishim për të shënuar, nuk do ta kishim problemin e Murat Yakin", ka shtuar Khaka.

Sipas medieve zvicereze, fakti që kombëtarja e tyre mundi të kualifikohet në turneun në Gjermani ishte pjesërisht për shkak të grupit mjaft të dobët në fazën kualifikuese.



## Muriqi mund të rikthehet ndaj Realit

MALLORCA, 22 NËNTOR - Sulmuesi Vedat Muriqi e ka nisur fazën e rehabilitimit pas lëndimit që e kishte pësuar të dielën e 12 nëntorit teksa po e përfaqësonte Kosovën në duel me Izraelin. Pesë ditë më pas, "Pirati" ka përfunduar në Mallorca, ndërsa me 17 të këtij

muaji në qytetin ishullor u është nënshtruar kontrolleve mjekësore. Fillimisht u parapra që prizrenasi do të mungojë 4 deri në 6 javë dhe, sipas parashikimeve, nëse nuk ndodhin mrekullitë, 29-vjeçari do t'i humbë ndeshjet kundër Atletico Madridit, Cadizit,

Alavesit e Sevilës, ndërsa është e dyshimtë prania e tij kundër Osasunës, shkruan mediumi spanjoll "AS". E në rast se nuk do të jetë gati për takimet e fundit të vitit 2023, atëherë ish-futbollisti i Rizesporit, Fenerbahçes e Lazios, do të kthehet në fillim

të janarit. Më saktësisht, më 3 janar në ndeshje kundër Real Madridit në La Liga. "Gjithçka do të shkojë mirë", ka thënë Muriqi pasi e nisi fazën rehabilituese. Prizrenasi i ka realizuar 4 gola dhe i ka bërë 2 asistime në 12 ndeshje të zhvilluara.



## Newcastle planifikon rikthimin e Ronaldos dhe Benzemas në Evropë

NEWCASTLE UPON TYNE, 22 NËNTOR - Cristiano Ronaldo dhe Karim Benzema në të njëjtën skuadër, për më tepër sërish në Evropë. Pasi fituan gjithçka me Real Madridin, dy yjet e futbollit botëror mund të ribashkohen sërish, por këtë herë për të luajtur së bashku në Premier Ligë te klubi i Newcastle. Ashtu siç dihet, "qymyrxhinjtë" janë në pronësi të sheikëve sauditë dhe rregullorja e futbollit anglez i lejon klubet që janë në të njëjtën pronësi të huazojnë lojtarë. Al-Itihad ku luan Benzema dhe Al-Nassr ku luan Ronaldo janë në pronësi të familjes mbretërore, të njëjtën që drejtojnë edhe klubin e Newcastle. Për momentin, drejtuesit e klubit të Newcastle kanë prioritet të gjejnë një zëvendësues për Sandro Tonali në cilin është i pezulluar pas skandalit të basteve, për ta zëvendësuar italianin do të marrin Ruben Neves nga Al-Hilal. Në janar, kur të hapet merkato, Ronaldo dhe Benzema mund ta kenë shansin të rikthehen



edhe një herë në futbollin e rëndësishëm evropian, e sigurt është që nuk do të ishin kundër një huazimi të tillë. Klubet angleze kërkojnë një mocion për të rrëzuar

këtë rregull, por nuk siguruan 2/3 e votave, 13 klube votuan kundër, por duheshin 14, duke lënë në fuqi rregullin e huazimit të lojtarëve që janë në të njëjtën pronësi.

## Lakersat mposhtin Utah Jazzin, zhgënjën Philadelphia

LOS ANXHELOS, 22 NËNTOR - Lakersat korren fitoren e tretë radhazi në NBA, duke mundur me rezultat 131-99 Utah Jazzin, në një ndeshje pa histori. Anthony Davis me 26 pikë ishte shënuesi më i mirë, ndërkohë që 63 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Humbet skuadra e Philadelphia, që në fushën e saj u mund me rezultat 122-119 nga Clevelandi. Ndeshje me rivalitet, vendosur pas kohës shtesë, ku për Cavaliersi u dallua Garland me 32 pikë. Po 32 pikë realizoi edhe Embiid për Philadelphia, por që mbetën për statistikë. 309 pikë të realizuara në ndeshjen e fituar nga Indiana, që mundi me



rezultat 157-152 Atlantan, në një duel të jashtëzakonshëm, i denjë për "All Star". Haliburton realizoi 37 pikë e 16 asistime, ndërsa 38 pikët e Young për Atlanta mbetën për statistikë. Fiton edhe skuadra

e Phoenixit, që mundi me rezultat 120-107 Portlandin, ndeshje ku u dallua i zakonshmi Kevin Durant, autor i 31 pikëve. Ekipi i Orlando, falë 25 pikëve të Banchemo, mundi 126-107 Toronto.

### REZULTATET

Orlando Toronto	126-107
Atlanta - Indiana	152-157
Philadelphia - Cleveland	119-122
Phoenix - Portland	120-107
Lakers - Utah Jazz	131-99

## Mourinho mendon të largohet nga Roma

E ardhmja e Jose Mourinhos në krye të Romës është në dilemë. Strategu portugez, duke folur për mediet italiane, e ka lënë të hapur mundësinë e largimit

nga kryeqyteti italian. Ish-trajneri i disa klubeve të mëdha evropiane, ka thënë se nuk e di të ardhmen e tij. "Nuk e di nëse do të qëndroj. Nuk kam folur

me Friedkin, për këtë nuk mund të përgjigjem për të ardhmen time", ka thënë Mourinho. Portugezi gjatë verës që lamë

prapa kishte refuzuar një super-ofertë nga Arabia Saudite. Mourinho, sipas medieve të huaja, është i lidhur edhe me rikthimin në

krye të bankinës së Real Madridit pasi që Carlo Ancelotti në fund të këtij sezoni, do ta mbyllë aventurën te "Los Blancos".

### SHKURT

#### Shpallja e laureatëve në basketboll bëhet më 21 dhjetor

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka mbajtur mbledhjen në të cilën ka vendosur që Shpallja e Laureatëve të Vitit të bëhet më 21 dhjetor. Në këtë ceremoni do të shpallen më të mirët e vitit në basketbollin e Kosovës. Pikërisht në këtë event do të bëhet prezantimi i Logos së Superligës së Femrave, si dhe Ligave të Tjera të femrave/vajzave. Ndërkohë janë emëruar trajnerët dhe ndihmëstrajnerët e Përfaqësuesve të Reja të Kosovës (U16M, U16F, U18M, U20M). Te Kosova U16 Meshkujt përzgjedhës do të jetë Dion Pllana, ndërsa ndihmëstrajner Dëfrim Hashani. Te Kosova U16 Femrat përzgjedhëse do të jetë Hasan Bytyqi dhe ndihmëstrajner Melda Baliqi. Te Kosova U18 Meshkujt përzgjedhës do të jetë Brahim Veseli dhe ndihmëstrajnerët Elbesar Gështenja dhe Hekuran Husaj.

#### De Biasi largohet nga Kombëtarja e Azerbajxhanit

Gianni De Biasi ka vendosur t'i japë fund kohës së tij si trajner i kombëtares së Azerbajxhanit, duke i dhënë fund një periudhe trevjeçare në krye të ekipit kombëtar. Sipas "Tuttomercatoweb", De Biasi ka vendosur ta japë dorëheqjen si trajner i kombëtares së Azerbajxhanit, duke kërkuar një aventurë të re pas tre vitesh e katër muajsh në këtë rol. Ai ishte vendosur të largohej në fund të muajit, pavarësisht se kur i skadon kontrata. Trajneri 67-vjeçar mbikëqyri 39 ndeshje në krye të Azerbajxhanit, duke shënuar 10 fitore, tetë barazime dhe 21 humbje. Ndeshjet kryesore përfshijnë një fitore të fundit 3-0 ndaj Suedisë, një fitore 3-1 ndaj Maqedonisë së Veriut dhe një fitore 2-1 kundër Sllovakisë.

#### Messi për incidentin në Rio: Policia përdori dhunë ndaj tifozëve tanë

Më shumë sesa për suksesin e arritur në Rio, nga Leo Messi dhe Argjentina, të gjithë u ndalën në dhunën e ushtruar ndaj tifozëve argjentinas. Gjesti i kapitenit Messi, i cili u bënte me shenjë lojtarëve të dilnin nga fusha ka bërë xhiron në rrjet, detaj ku është ndalur edhe vetë "pleshti". "Ata po i godisnin njerëzit me shkopinj, përdorën dhunë ndaj tifozëve, ata po i rrihnin. Aty kishte edhe familjarë të lojtarëve. Të gjithë mendonim për familjet e tyre. Në këto momente nuk e di kurrë se çfarë po ndodh, nuk e ke mendjen në fushë, nuk e ke mendjen për të luajtur futboll", u shpreh Messi pas ndeshjes.

#### Deschamps: Synojmë triumfin në 'Euro 2024'

Franca luajti baras me Greqinë (2-2) në ndeshjen e fundit kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2024". Trajneri Didier Deschamps ka deklaruar se konkurrenca do të jetë e fortë në Evropian, por se Franca synon të triumfojë. "Do të kishim dashur një mbyllje ndryshe, por Greqia ka vlera dhe e kishim parë edhe në ndeshjen e zhvilluar në fushën tonë. Tani duhet të fillojmë të mendojmë për Evropianin, ku do të synojmë patjetër ta themi fjalën tonë pavarësisht se konkurrenca do të jetë shumë e lartë dhe mund të ketë të papritura", ka deklaruar Deschamps.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Emri i biznesit B5 Inframain SH.P.K. si dhe me emër tregtar B5 Infrastructur&Maintance me Numër Unik Identifikues: 811574583, ka marr vendim për zvogëlim të kapitalit nga 2000.000 në 20.000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Haki Leci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale "Shtjefën Gjeqovi".

- Rasim Pllana Shpall te pavlefshme dëftesat e vitit te III,IV dhe diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".

- Ibrahim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Albiana Ademaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Isa Boletini" Osek Hyl KK Gjakovë.

- Gazmend Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - Vllshfmu "Lekë Dukagjini" Prizren.

- Shkurte Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Anadolu" Mamushë.

- Dukagjin Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

- Urim Khanemi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Imer Himaj nga Osek Hyla KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Transport Rrugorë.

- Bedri Nezaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klm I, II të Gjimanzit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fisnik Kumnova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë Gjakovë.

- Ferdane Alidemaj shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".

- Ubejd Gashi shpall te pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës me nr. të diplomës 4157.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

